VENDIM
Nr.205, datë 20.12.2010

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO KRUJA" SUBJEKTIT PRIVAT FIZIK LULËZIM SPATA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.97, datë 27.8.2010 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin privat fizik Lulëzim Spata, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte ekstrakti i Qendrës së Regjistrit Tregtar, deklarata noteriale, garancia bankare, projekti teknik, plani i implementimit të projektit, si dhe CV-të e anëtarëve të bordit drejtues.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati